

VENDIM
Nr. 405, datë 5.7.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR PËR
GJYKATËN KUSHTETUESE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE KAPITALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale”, të programit buxhetor 03320 “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”, i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, për rikonstruksionin e godinës së Gjykatës Kushtetuese.

2. Efekti financiar, prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Gjykata Kushtetuese dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku